

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

DREJTORIA RAJONALE FIER

Nr. _____ Prot.

Fier, më ____/____/2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje përcjellesa dhe aksesore linje”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV - Materiale elektrike 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 40,000,000 (dyzet milion) **lekë, pa TVSH.**

Ndarje ne Lote - nuk ka

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane e OSSH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “OSSH sh.a Drejtoria Rajonale FIER” ka vendosur që kjo procedure të mos jete ne lote sipas arsytimit të mëposhtem:

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

regullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e mosndarjes së procedurës në lote, me përmbajtjen si më poshtë:

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vetë objekti i prokurimit kemi të bëjmë vetëm me një kategori materialesh, të vetëm furnizim mallrash (**Blerje materiale teknike për mirëmbajtjen e linjave elektrike**) të cilat klasifikohen në të njëjtën familje të mallrave objekt prokurimi.

Kontraktuesi i cili do të ofrojë këto pajisje, duhet të zotërojë manuale të detajuara të instalimit, operimit dhe mirëmbajtjes dhe dokumenteve të tjera të specifikuara në Specifikimet Teknike. Për këtë arsye, të gjitha proceset e këtij furnizimi, që të funksionojnë dhe të merren në dorëzim në kohë me cilësinë dhe garancinë e nevojshme duhet të realizohet në një procedurë të vetme dhe për përgjegjësinë e proceseve nga një operator ose bashkim operatorësh. Është e pamundur që kjo procedurë të ndahet në lote nga vetë natyra e saj, si dhe për arsye të koordinimit të grupeve për proceset e punës që do të kryhen.

Për sa mësipër dhe për të shmangur shumë procese që mund të lindin, kjo procedurë nuk është e mundur të ndahet në lote por duhet të bëhet nga një OE për arsye dhe të garancisë.

Referuar legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t’u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje mallrash të vetme dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Procedura e prokurimit me objekt sa me sipër ka për qëllim furnizimin e Autoritetit Kontraktor me përcjellës AL-Ç, në funksion të veprimtarisë së punës së AK.

Gjithashtu, vonesat që mund të shkaktohen nga marrëdhënia me disa operatore ekonomike mund të vështirësojë edhe nevojat e AK për ushtrimin e funksionit të saj, dhe mund të krijohen probleme në linjat e transmetimit të energjisë elektrike.

AK është një institucion i rëndësishëm së vecantë në sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe gjithashtu bën edhe lidhjet e nevojshme me rajonet e tjera të OSSH Sh.A

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të balanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilanci të njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).*

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllëgoaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor). Kur oferta paraqitet nga një bashkim

operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (të vitit 2026) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 pika 6, dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi për pikat 2.2.1, 2.2.2, 2.2.3: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin*

ose e kalon shumë prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Vlera e përcaktuar e xhiros i shërben autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Objekti i kësaj kontrate konsiston në "Blerje Izolatorë, Shkarkues TM, Siguresa TM/TU, Bazamant Siguresa TU+Fishekë", ku paisjet konsiderohen pajisje teknologjike delikate dhe te domosdoshme për shërbimin normal të rrjetit të shpërndarjes. Duke marrë në konsideratë për sa mesipër, ku theksohet rëndësia e këtij shërbimi, gjithashtu duke marrë në konsideratë vlerën e parashikuar të cilës na kalon në "Procedurë mbi kufirin e lartë monetar", afatet e të cilës shtrihen në kohë, në mënyrë që autoritetit/entit kontraktor të njohë gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, për një konkurrencë sa më të fortë dhe gjithëpërfshirëse, është përcaktuar dhe vlera e mesipërme

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 43 pika 2/a të VKM Nr 285 datë 19.05.2021 .

Gjithashtu në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e kërkuar që është brenda vlerës së përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontratat e ngjashme, të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet .

Në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit / distributorit për cdo artikull të kerkuar (sipas preventivit). Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut /eve të prodhuesit/ve për mallrat objekt prokurimi ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë se janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.* Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-se, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, Operatorët Ekonomikë, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve

zyrtare të kryera, lëshuar nga institucione të autorizuar, ose nga prodhuesi, për mallrat e cituar me sipër, për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejtën e AK të kërkojë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bëjë përzgjedhjen e OE-së fituese. Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit, e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar duhet të paraqesë certifikatën ISO, pasi duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim/kontratës së bashkëpunimit.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propozicion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vërtetuar dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kërkesa në lidhje me këtë certifikatë është në përputhje me nenin 44, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarim që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit / ve është sipas standartit ISO 9001 – 2015 (ose ekuivalente) dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara.

Argumentimi: Ky kriter është kërkuar pasi vetëm prodhuesi mund të vërtetojë se produktet e prodhuara kanë në fakt, karakteristikat e deklaruara. Certifikata e sigurimit të cilësisë ka për qëllim të plotësojë deklaratën fillestare apo certifikatën e përshtatshmërisë. Si provë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e produktit, prodhuesi pajiset me certifikatën për cilësinë e sistemit të kontrollit i cili monitoron fabrikimin e produkteve të caktuara. Këto certifikata bazohen në standardet ndërkombëtare ISO 9001: 2000.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë (vetëdeklarim) ku të shprehet që materialet të kenë markim CE./ ekuivalente me kërkesat e standardeve CE (sipas specifikimeve teknike).

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës për produktet që kerkohen me sipër, është një kërkesë e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues direkt i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE-te pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësive të mallit që do të ofertohej, rrjedhimisht është e drejtë e AK-se të kërkojë ofertuesve që të paraqesin deklarata për të vertetuar cilësinë e prodhimit të produkteve të procedurës së prokurimit. Për Autoritetin Kontraktor është e nevojshme që, Operatorët ekonomikë gjatë ofertimit të tyre të deklarojnë se zotërojnë kapacitetet teknike të lidhura me standardet e produkteve për të cilat ofertohej. Kërkesa e mesipërme ka si qëllim të sigurojë AK-ne, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standarteve të mirëpraktuara në DST. Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike për mallrat (sipas preventivit) në të cilën duhet të paraqiten të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe çëb i firmës furnizuese.

Argumentim: Së pari, skeda teknike me të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe çëbit të furnizuesit ofron një nivel të lartë të transparencës në procesin e tenderimit. Kjo transparencë është e rëndësishme për të siguruar që të gjithë operatorët ekonomikë kanë akses në informacionin e nevojshëm për të bërë një vlerësim të saktë të produkteve dhe ofertave të tyre.

Së dyti, ky kriter siguron që operatorët ekonomikë janë të përgatitur dhe të informuar mirë për mallrat që duan të blejnë. Me të dhënat e sakta të kodit të produktit dhe faqes së internetit të furnizuesit, ata kanë mundësi të marrin informacion më të thellë dhe të ndërtojnë një kuptim më të mirë për cilësitë dhe karakteristikat e mallrave të ofruara nga furnizuesi. Kjo i ndihmon ata të bëjnë zgjedhjen e duhur në përputhje me nevojat dhe synimet e tyre konkrete.

Për këto arsye ky kriter promovon transparencën, ndihmon operatorët ekonomikë të jenë të përgatitur dhe të informuar mirë, dhe siguron integritetin e informacionit të paraqitur në procesin e tenderimit. Kjo është në përputhje me synimet për një proces të drejtë dhe të hapur të blerjes së mallrave.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

a. Emri i kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, me mallrat e të cilit OE do të paraqitet në tender.

b. Emërtimi i Katalogut ose i skedës teknike

c. Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli

Nr.	Emërtimi i produktit	Modeli i Produktit	Vendi i origjines se mallit	Prodhuesi / Distributori i autorizuar nga	Nr. faqes në katalog
1					

2					
Etj.,					

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedarat teknike të dorëzuara.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, persa i perket ofertes teknike.

Së pari, ofrimi teknik kërkon që operatorët ekonomikë të paraqesin një përshkrim të detajuar të mallrave që ofrojnë. Përmes kësaj kërkesë, AK ka një pamje të qartë të cilësive të mallrave dhe mund të krahasojnë ofertat në mënyrë objektive për të zgjedhur atë që plotëson më mirë nevojat e tyre.

Së dyti, ofrimi teknik i jep AK-se një shans për të vlerësuar aftësitë teknike të operatorëve ekonomikë. Përmes analizës së ofertave teknike, AK mund të vlerësojnë nëse operatori ekonomik ka njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për të përdorur dhe mirëmbajtur mallrat që ofron.

Së treti, nëse operatori ekonomik nuk paraqet një ofertë teknike të plotë dhe të qartë, AK mund të hasë vështirësi në vlerësim.

Për këto arsye, vendosja e kriterit të paraqitjes së ofertës teknike është i arsyeshëm dhe e ndihmon në sigurimin e një procesi të drejtë dhe të efektshëm të blerjes. Ky kriter jep informacion të rëndësishëm, siguron cilësi të mallrave. Kjo është një mënyrë e mirë për të garantuar që furnizimi me keto mallra të realizohet me sukses.

2.3.10 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, Operatorët Ekonomik ofertues duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH Sh.A Fier, mostrat e mallrave në momentin e hapjes së ofertave, perkatesisht:

- Percjelles Alumin-Çelik (ACSR) 16 mm²
- Percjelles Alumin-Çelik (ACSR) 25 mm²
- Percjelles Alumin-Çelik (ACSR) 35 mm²

Për të përmbushur këtë kërkesë operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë minimalisht nga 1m për secilin product.

Argumentim: Në zbatim të shkronjës a), pikës 6, të nenit 40, të Seksionit III, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si

informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Një kërkesë e tillë është e nevojshme për të konfirmuar nëse janë përmbushur kërkesat minimale të specifikimeve teknike të kërkuara për mallrat, objekt prokurimi.

2.3.11 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë: Kamion me vinç me kapacitet majtës ≤ 12 ton. Për mjetet me rrota, që shënohen në regjistra publike, që merren me qira, të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi dhe leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, leja e transportit të mallrave (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton) dhe foto përkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetin që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit objekt prokurimi dhe pozicionin gjeografik të territorit ku do të realizohen furnizimet dhe shërbimet sipas nevojave.

Operatorët ekonomikë, bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, paraqesin si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe nenit 26 të VKM 285 dt.19.05.2021.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”

të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i specialisteve sipas standarteve, të derguara nga Drejtoria Qendrore, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

NJESIA E PROKURIMIT

Personi përgjegjës

Specialist

Specialist